



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI

Nr. 1416/1 Prot.

Tiranë, më 13.07 2026

V E N D I M

Nr. 108 dt. 13.07 2026

“PËR
MBËSHTETJEN E KËRKESAVE TË PARASHTRUARA NË PETICIONIN ME
NR.3021/32 DATË 10.07.2026”

Në zbatim të nenit 3, nenit 38 të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, nenit 7, nenit 20 të Statutit të UST, nenit 11 të Rregullores së UST-së, dhe në vijim të Peticionit me nr.3021/32 datë 10.07.2026 me lëndë “Peticion për shqyrtimin e njoftimeve mbi detyrimet e pretenduara ndaj stafit dhe studentëve, garantimin e së drejtës për informim dhe dëgjim, mbrojtjen e pagës, pezullimin e çdo veprimi financiar, nisjen e hetimit administrativ dhe trajtimin e çështjes edhe si sinjalizim administrativ”, Senati në mbledhjen e datës 13.07.2026,

V E N D O S I :

1. Mbështetjen e kërkesave të parashtruara në Peticionin me nr.3021/32 datë 10.07.2026 me lëndë “Peticion për shqyrtimin e njoftimeve mbi detyrimet e pretenduara ndaj stafit dhe studentëve, garantimin e së drejtës për informim dhe dëgjim, mbrojtjen e pagës, pezullimin e çdo veprimi financiar, nisjen e hetimit administrativ dhe trajtimin e çështjes edhe si sinjalizim administrativ”.
2. Senati Akademik i kërkon Bordit të Administrimit ngrirjen e urdhërave të brendshëm të Administratorit të UST me nr.47 datë 15.05.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë Asistent Lektor” dhe nr. 62 datë 03.06.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të arendshëm të MA” dhe vlerësimin e procedurës së ndjekur në zbatim të këtyre urdhërave.

3. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit, njësive të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

